



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



THIRRJE PËR PJESËMARRJE TRAJNIM PËR TRAJNERËT

Hyrje

Në kuadër të projektit NAGE – Rrjetëzim dhe Advokaci për Ekonominë e Gjelbër - me qëllim për të forcuar institucionalisht organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në përmbushje të rolit të tyre advokues në proceset reformuese rurale dhe bujqësore organizohen një seri aktiviteteesh Trajnim për Trajnerët (ToT).

Aktivitetet trajnuese do të zhvillohen rreth dy moduleve kryesore -“Menaxhimi i Përgjithshëm i OSHC-ve rurale” dhe “Trajnim specifik mbi programin (Advokaci dhe Ekonomi e Gjelbër)” - të ndara në tematika specifike, përgjatë muajve Shtator 2018 – Mars 2019.

Moduli 1	Menaxhimi i Përgjithshëm i OSHC-ve	ToT 1.1 në Qeverisje Transparente dhe të Përgjegjshme ToT 1.2 në Planifikim dhe Raportim ToT 1.3 në Menaxhimin financiar dhe diversifikimin e fondeve	Tre mujori i fundit 2018
Moduli 2	Trajnim specifik mbi programin – Advokaci dhe Ekonomi e Gjelbër	ToT 2.1 në Advokaci, Lobim, Rrjetëzim dhe Fuqizimin e rrjeteve dhe të organizatave anëtare të tyre ToT 2.2 Ekonomia e Gjelbër dhe Sipërmarrja	Tremujori i parë 2019

Për secilin nga ToT e mësipërme do të hapet thirrje për Aplikime, për të përzgjedhur tre përfaqësues nga organizatat anëtare të ANRD.

Personat e trajnuar në tematikat e mësipërme, pas trajnimit ToT, do të ofrojnë trajnim në tematikën përkatëse për përfaqësuesit e tjerë të OSHC-ve rurale në Shqipëri, të angazhuar si në organizatat anëtare të ANRD ashtu edhe në organizatat të tjera jo anëtare, përkundrejt shpërblyerimit financiar të parashikuar në projekt.

Shpenzimet e transportit, akomodimit dhe ushqimit gjatë kohës së trajnimit do të mbulohen nga organizatat zbatuese të projektit NAGE.





Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



THIRRJE PËR PJESËMARRJE
"MENAXHIMI I PËRGJITHSHËM I OSHC-ve-
Qeverisje Transparente dhe e Përgjegjshme"

Shkup, Maqedoni
24-25 shtator

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) në rolin e organizatës zbatuese të projektit NAGE – Rrjetëzim dhe Advokaci për Ekonominë e Gjelbër - në Shqipëri, hap thirrjen për pjesëmarrje në "Trajnim për Trajnerët – Qeverisja Transparente dhe e Përgjegjshme" që do të zhvillohet më 24 – 25 Shtator 2018, në Shkup, Maqedoni.

Pjesëmarrja dhe përzgjedhja:

Kjo thirrje i drejtohet organizatave anëtare të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural që të inkurajojnë përfaqësuesit dhe stafin e tyre të aplikojnë për të marrë pjesë në trajnimin ToT Qeverisja Transparente dhe e Përgjegjshme që do të organizohet më 24-25 shtator në Shkup, Maqedoni. Inkurajohen të aplikojnë drejtues dhe anëtarë të bordeve drejtuese të organizatave, menaxherë të lartë ose persona të tjerë me përvojë në qeverisjen e organizatave të shoqërisë civile. Gjithashtu, përvoja të mëparshme në ofrimin e trajnimeve dhe njohja e mirë e gjuhës angleze do të jenë të kritere në procesin e përzgjedhjes.

Në fund të procesit do të përzgjidhen tre përfaqësues bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. Relevanca e temës së trajnimit me pozicionin e punës
2. Backgroundi arsimor dhe përvoja profesionale
3. Njohuritë e gjuhës angleze
4. Motivimi dhe gadishmëria për t'u angazhuar në aktivitete trajnimi për të ndarë know-how e fituar me të tjerë përfaqësues të OSHC-ve rurale.

Kandidatët e interesuar janë të ftuar të aplikojnë duke plotësuar dhe dërguar Formën e Aplikimit (e linkuar) në adresën e emailit info@anrd.al, brenda datës 7 Shtator 2018, ora 17.00. Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen brenda datës 10 Shtator 2018.

[Këtu mund të shkarkoni Formën e Aplikimit.](#)

